



POP

**PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE**

**NË MOS TI, KUSH?
NË MOS SOT, KUR?**

**- NGRIJE ZËRIN
NË ZGJEDHJET
VENDORE!**



Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP" synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy." Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

POP

**PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE**



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

ZGJEDHJET VENDORE 14 MAJ 2023

KONTRATA SOCIALE



TIRANË



KONTRATA SOCIALE 2023 – 2027

BASHKIA TIRANË

Përballja e Ofertave Politike (POP) është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare, të cilat punojnë në 12 bashki të Shqipërisë. Në bashkinë Tiranë, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga “Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim” (GADC). GADC është një organizatë lider në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor me rezultate të suksesshme në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, promovimin e barazisë gjinore dhe demokracisë me pjesëmarrje në shoqërinë shqiptare.

Kontrata sociale hartohet nga POP në çdo fushatë elektorale gjatë Zgjedhjeve Vendore në Shqipëri. Hartimi i Kontratës Sociale bazohet në takime me qytetarë të grupeve të ndryshme dhe bazuar në një metodologji për të marrë mendimet dhe prioritetet e tyre.

Në hartimin e kontratës sociale 2023-2027 janë marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e grupeve të ndryshme të qytetarëve brenda territorit të Bashkisë së Tiranës, me një fokus të veçantë për grupet e cenushme.

PRIORITETET KRYESORE

Prioriteti 1. Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integrimit evropian në nivel vendor

- Pjesëmarrja dhe Përfaqësimi i Qytetarëve: Bashkia do të inkurajojë pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendore të vendimmarrjes
- Qeverisja transparente: Bashkia do të funksionojë me transparencë dhe integritet, duke u ofruar banorëve akses në informacione për vendimet, buxhetet dhe planet e saj.
- Rritja e aksesit të qytetarëve nëpërmjet digjitalizimit të sistemit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore përmes krijimit dhe vendosjes së E-Platformave.
- Forcimi i qeverisjes së mirë në nivelin vendor, sipas 4 objektivave specifike të Strategjisë për Decentralizim dhe Vetëqeverisje Lokale 2023-2030: (i) sigurimi i qeverisjes së hapur, rritja e transparencës, përgjegjshmëri dhe shtrirje më e madhe e e-qeverisjes në nivel vendor; (ii) Integrimi Evropian dhe qeveria vendore; (iii) forcimi i strukturave komunitare në nivel vendor (Komisionet qytetare, Kryetarët e fshatrave, Ndërlidhësit qytetarë); (iv) adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore. Ngritja e kapaciteteve të stafit të bashkisë dhe rritja e efikasitetit në tërësi të strukturave të qeverisjes vendore në linjë me Strategjinë për Decentralizim dhe Vetëqeverisjen Lokale 2023-2030.
- Qytetarëve do tu kthehet përgjigje ankesash apo kërkesash, brenda afateve që parashikon Ligji për të Drejtën e Informimit nr. 119/2014.
- Të përmirësohet informimi dhe komunikimi i Bashkisë me qytetarët në lidhje me programet e nxitjes së bizneseve dhe punësimit, për të cilat një pjesë e madhe e qytetarëve nuk kanë dijeni, edhe pse janë të interesuar të aplikojnë.
- Qytetarët kërkojnë të informohen më shumë mbi zhvillimin e takimeve publike dhe të Buxhetimit me Pjesëmarrje, në mënyrë që të jenë më të përfshirë në vendimmarrje për çështjet që i shqetësojnë.

Prioriteti 2. Drejtësia Sociale

- Funkcionimi efektiv i Mekanizmit të Referimit për të adresuar dhunën me bazë gjinore. Krijimi i një databaze me të gjitha rastet e dhunës me bazë gjinore që trajtohen pranë Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale, sektori i Përfshirjes Sociale edhe Barazisë Gjinore në Bashkinë e Tiranës.
- Zhvillimi i më shumë fushatave dhe programeve ndërgjegjësuese që trajtojnë në mënyrë specifike dhunën ndaj grave dhe vajzave, si dhe dhunën në familje. Është thelbësore që këto programe të prekin gratë dhe vajzat në zonat rurale, ku ato janë më të cenushme.
- Zgjerimi i shërbimeve për fuqizimin dhe riintegrimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore, duke njohur rolin vendimtar të shërbimeve mbështetëse gjithëpërfshirëse për të ndihmuar të mbijetuarat të rindërtojnë jetën e tyre. Kjo përfshin aksesin në një gamë të gjerë burimesh dhe asistencë, si ndihma ligjore, trajnimi për punë dhe këshillimi për shëndetin mendor etj.
- Të rritet kërkesa e llogarisë ndaj administratorëve të njësive administrative dhe kryetarëve të fshatrave në identifikimin e rasteve të dhunës në familje dhe raportimin pranë Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale, sektori i Përfshirjes Sociale edhe Barazisë Gjinore.
- Me ndihmën e organizatave të shoqërisë civile dhe donatorëve, të printohen postera me informacion kundër dhunës me bazë gjinore, përfshirë kontaktet kryesore të institucioneve private dhe publike që veprojnë në territorin e Bashkisë Tiranë, ku mund të raportohet dhuna me bazë gjinore. Këto postera të vendosen në vende të dukshme në të gjitha zyrat dhe strukturat bashkiake.

- Të diversifikohet dhe rritet buxheti për organizatat e shoqërisë civile që japin shërbime për grupet e marginalizuara.
- Zbatimi i 5 Planeve Sociale të Bashkisë Tiranë përmes alokimit të buxheteve të nevojshme dhe hartimit të raporteve vjetore ose 2 vjeçare me informacion në lidhje me zbatimin e pesë Planeve sociale Vendore.

- Plani Social 2022-2024
- Plani për Strehimin Social në Tiranë 2022-2027
- Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2024

Prioriteti 3. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor.

- Të rritet me 25 % në vit fondi në dispozicion të fuqizimit ekonomik të grave e vajzave sipërmarrëse në territorin e Bashkisë Tiranë.
- Të krijohen modele financimi dhe mentorimi në bashkëpunim me aktorë të tjerë në ndihmë të grave dhe vajzave fermere.
- Të krijohen për promovimin e agroturizmit duke njohur kontributin e grave dhe vajzave.
- Të krijohen hapësira tregëtare për gratë artizane që kryejnë veprimtari në territorin e Bashkisë Tiranë.

Prioriteti 4. Transport publik i aksesueshëm dhe i sigurtë për të gjithë qytetarët e Tiranës.

- Afishimi i stacioneve dhe orareve në vendqëndrimet e autobusëve në të gjitha njësitë administrative të Tiranës.
- Adresimi i problemit të mbingarkesës dhe rritja e shpeshësisë së lëvizjes së autobusëve të linjave.

Prioriteti 5. Garantimi dhe aksesit në ujë të pijshëm dhe të konsumueshëm.

- Qytetarët kërkojnë të mos e blejnë ujin që konsumojnë, ndaj kërkojnë siguri në lidhje me këtë element jetësor.

Prioriteti 6. Infrastruktura rrugore

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, trotuareve dhe sinjalizimit rrugor.
- Rritja e ndriçimit të rrugëve sipas parimit “Qytete të sigurta”

Prioriteti 7. Shkollat, Kopshtet dhe Çerdhet

- Ofrimi i shërbimit “after school” në më shumë shkolla të Tiranës.
- Në njësinë administrative nr. 7 ka nevojë për ndezjen e kaldajave gjatë dimrit,
- Në njësinë administrative Farkë, shkolla Farka e Madhe është e bashkuar (ka edhe 9-vjeçaren, edhe gjimnazin në të njëjtin vend) dhe funksionon me turne. Ndarja e dy sistemeve në shkolla të veçuara. Ndërtimi i një park lojërash dhe palestër për zhvillimin e orës së fizikulturës pranë kësaj shkolle.
- Ndërtimi i çerdhes në Farkë dhe zgjatja e orarit të kopshtit të fëmijëve deri në orën 16:30 duke përfshirë edhe drekën.

Prioriteti 8. Mbështetja e fermerëve

- Krijimi i një tregu për shitjen e produkteve bujqësore në njësinë administrative në Baldushk, sepse fermerët nuk kanë mjete transporti për të shitur produktet në tregun e krijuar në Farkë.
- Në njësinë administrative Baldushk qytetarët kërkojnë lehtësira për ndërtimin e stallave të gjësë së gjallë në tokat e tyre.

Prioriteti 9. Adresimi i Ndotjes Urbane përmes Politikave të Qëndrueshme të Energjisë

- Vijueshmëria e promovimit të politikave që synojnë reduktimin e ndikimit të ndotjes në zonat urbane me popullsi të dendur dhe për të inkurajuar miratimin e politikave të qëndrueshme për përdorimin e energjisë së rinovueshme si një alternativë ndaj lëndëve djegëse fosile.
- Pushteti vendor t'i japë përparësi planifikimit dhe financimit të politikave të ndryshimeve klimatike në zonat që janë veçanërisht të cenushme ndaj kushteve atmosferike, duke demonstruar një ndërgjegjësim të shtuar për ndikimin e mundshëm të këtyre ndryshimeve.

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Bashkia Tiranë

Mirela Arqimandriti
Drejtoresh Ekzekutive

Erion Veliaj
Kryetar